

Akt Themelimi
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "SAI SHOES"

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , " Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 27/01/2023 me ortakët :

1. **Antonio SPECCHIO** me ID H13517001H
2. **Iqmet XHELAJ** me ID J90628092C

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "SAI SHOES" me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur "SAI SHOES" . Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Neni 2

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë "SAI SHOES" do te jetë: Vlore, Lagjja "15 Tetori", Rruga "Shefit Zenaj", Zone Kadastrale 8602, Nd.12, Objekti nr.3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **saishpk23@gmail.com**.

Shoqëria mund te ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Aktivitet ne fushen e fasonerise: prerje, qepje, montim suprina kepucesh, kepuce te te gjitha llojeve e formave, tregtim me pakice e shumice e tyre. Import-eksport materiale industrial te ndryshme, makineri e pajisje, lende te para et. Aktivitet ne fushen e tregtise: tregti me shumice e pakice te materialeve te ndryshme te te gjitha llojeve etj.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do te jetë me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shpërbehet në cdo kohë dhe për cfarëdo lloj shkaku.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "SAI SHOES" do të jetë 100 (njqind) Leke dhe është 2 kuota.

1. Ortaku themelues **Antonio SPECCHIO**: Zotërues i 1 kuote që përbëjnë 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë. (50 pesedhjete lekë)
2. Ortaku themelues **Iqmet XHELAJ**: Zotërues i 1 kuote që përbëjnë 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë. (50 pesedhjete lekë)

Neni 6

Drejtimi i shoqërisë

1. Shoqëria do të drejtohet nga administratori **Z. Iqmet XHELAJ** me ID **J90628092C** i datelindjes **28.06.1999**.

Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një perfaqesues i pajisur me prokurë të posacme .

Neni 7

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiarë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .


Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “SAI SHOES”.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortaku i “SAI SHOES”

Iqmet XHELAJ



Ortaku i “SAI SHOES”

Antonio SPECCHIO

